



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 02.08.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.07.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “BERISHA COM” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e Qarkores së Qytetit”, Nr. i prokurimit- 632-22-6893-5-1-1, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërishtë e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e dt.26.07.2022, e parashtruar nga Operatori Ekonomik “BERISHA COM” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e Qarkores së Qytetit”, Nr. i prokurimit- 632-22-6893-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-063-511, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 08.07.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Përmirësohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, publikuar me datë: 08.07.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

## A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "BERISHA COM " SH.P.K., ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim me dt.26.07.2022 , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e Qarkores së Qytetit " , Nr. i prokurimit- 632-22-6893-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-063-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 02.08.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik "BERISHA COM " SH.P.K., të dt.26.07.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorit në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të bëjë përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj  
  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit  
